



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4842 prot.

Shkodër, më 02.03. 2026

VENDIM

Nr. 17, datë 27.02.2026

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË APLIKIMIT PËR ZBATIMIN E SKEMËS SË
GRANTEVE “BIZNESE INOVATIVE”, VITI 2026–2028**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.02.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, në mbështetje të nenit 28, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”; fiches së projektit P.AC141.Q1.O2.A3 “Skemë granti për biznese inovative”; Kërkesës nr. 1024 prot., datë 15.01.2026, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me objekt: “Njoftim për ndihmën shtetërore për projektin ‘Skemë granti për biznese inovative’ nëpërmjet mbështetjes financiare me grante”; si dhe Shkresës së Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 453/2 prot., datë 12.02.2026, me objekt: “Komunikohet vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore”, dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzuesin e Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Fondi total i Skemës së Granteve për vitin 2026 është 5,000,000 lekë, nga të cilat 2,500,000 lekë janë të parashikuara në programin buxhetor AC141 “Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural”, aktiviteti P.AC141.Q1.O2.A3 “Skemë granti për biznese inovative”, ndërsa 2,500,000 lekë do të përballohen përmes rialokimit të fondeve të trashëguara nga viti 2025, në të njëjtin program buxhetor, duke u financuar plotësisht nga Bashkia Shkodër.
3. Plani i Ndihmës Shtetërore do të zbatohet për periudhën 2026–2028, në përputhje me Shkresën e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 453/2 prot., datë 12.02.2026. Vlera totale e vënë në dispozicion për çdo vit buxhetor është objekt rishikimi në përputhje me parashikimet dhe miratimet buxhetore vjetore.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 38 vota

Vota Pro	38
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	3

Zbardhur me datë 02.03.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

